



BASHKIA TIRANË

VKT NR. _____ DATË
_____/_____/202__

MIRATOHET

ERION VELIAJ

KRYETAR

RAPORT TEKNIK

“NDËRTIM RRUGA “ALIMDHEJVE”, FSHATI IBË E SIPËRME”

PROJEKTUES

“VIANTE KONSTRUKSION” SH.P.K. & “FOCUS ARCHITETURE” SH.P.K.



**PËRFAQËSUAR NGA: “VIANTE KONSTRUKSION” SH.P.K
2024**

PERMBAJTJA

1	INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM.....	3
1.1	Hyrje.....	3
1.2	Përshkrimi i gjendjes ekzistuese.....	4
2	STUDIMI TOPOGRAFIK.....	8
2.1	Hyrje.....	8
2.2	Pasisjet dhe Instrumentat e perdorur.....	9
2.3	Rilevimi i Siperfaqes se matur.....	10
2.4	Pershkrimi i punes ne Terren.....	12
2.5	Katalogu i koordinatave.....	12
3	PARAMETRAT PROJEKTUES TE RRUGEVE.....	16
3.1	Standartet Rrugore te Projektimit.....	16
3.2	Klasifikimi rrugor.....	16
3.3	Elementet Gjeometrike te Projektimit ne Plan.....	17
4	PROJEKTIMI DHE PERSHKRIMI I GJURMES.....	21
4.1	Projektimi i gjurmes.....	21
4.2	Pershkrimi i gjurmes.....	22
5	STUDIMI DHE PROJEKTIMI I SHTRESAVE RRUGORE.....	24
5.1	Objekti.....	24
5.2	Metoda e zgjedhur per llogaritje.....	25
5.3	Paketat e propozuara.....	25
5.4	Ngarkesat e Trafikut.....	26
6	LLOGARITJET HIDRAULIKE DHE HIDROLOGJIA.....	27
6.1	Hidrologjia.....	27
6.2	Kushtet klimatike.....	29
6.3	LLOGARITJE HIDRAULIKE E KANALIZIMEVE TE UJERAVE TE NDOTURA DHE TE SHIUT.....	36
7	SINJALISTIKA DHE SIGURIA RRUGORE.....	38
7.1	Sinjalistika.....	39
	Sinjalistika vertikale.....	39
	Vendosja.....	39
	Sinjalet e Ndalimit.....	39
	Sinjalet e rrezikut.....	39
	Sinjalet e perparemise.....	39
	Sinjalet detyruese.....	39
	Sinjalizimi horizontal.....	40
8	RELACIONI ELEKTRIK.....	40
9	VLERESIMI I KOSTOS SE PROJEKTIT.....	45
9.1	Te pergjithshme mbi hartimin e nje preventivi.....	45
9.2	Vlera e Kostove.....	46

1 INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM

1.1 Hyrje

Bashkia Tiranë, në kuadër të zhvillit urban të qytetit dhe përmirësimit të infrastrukturës publike, kërkon të realizojë projektin e zbatimit (studimin dhe projektimin) për objektin: “NDËRTIM RRUGA “ALIMDHEJVE”, FSHATI IBË E SIPËRME”

Kërkesa për zhvillimin e projektit të infrastrukturave bazohet në nevojën për rizhvillimin e zones

Sistemi Infrastrukturor i Planit të Përgjithshëm vendor ka për qëllim :

- a) Krijimin dhe përmirësimin e aksesit të zonave të reja dhe atyre ekzistuese urbane, brenda dhe jashtë sistemit urban;
- b) Përcaktimin e territorit për ndërtimin e infrastrukturave publike;
- c) Përcaktimin e territorit për ndërtimin e infrastrukturave nëntokësore kyresore publike.

Ndërhyrja në këtë zonë me përmirësim të infrastrukturës rrugore synon në një përfaqje të integruar të zhvillimit social, kulturor, ekonomik, përmirësimin e cilësisë së jetës së studenteve por edhe qytetarëve, si dhe mbrojtjes së ambjentit.

Kjo politikë ka për qëllim ofrimin me cilësi, sipas standardeve bashkëkohore të shërbimeve publike në të gjithë territorin, përmirësimin e cilësisë së shërbimit me ujë, infrastrukturës së kanalizimeve të ujrave të shiut, shërbimit të mbledhjes së mbetjeve urbane dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore.

Sa me lart, referuar detyres së projektimit dhe qëllimit që kërkon të arrihet, rezultojnë se rrugët “NDËRTIM RRUGA “ALIMDHEJVE”, FSHATI IBË E SIPËRME” do të kenë elementet të cilat do të përshkruhen më poshtë në këtë raport.



1.2 Përshkrimi i gjendjes ekzistuese

Pas azhornimit ne terren dhe rilevimit topografik me poshtë do te përshkruajmë gjendjen ekzistuese:

Ky segment ka nje gjatesi prej 800ml. Gjeresia e rruges varjon nga 2-3.5m dhe kufizohet nga te dyja anet me rrethime me mur ose gardh. . Një segment i rrugës është me rërë bituminoze dhe e dëmtuar totalisht, një pjesë me cakell dhe një segment me beton.

- Nuk kishte kanalizime te ujerave te bardha dhe te zeza.
- Ndricim nuk kishte.
- Kishte linje ujësjellësi por duhet verifikuar gjendja dhe funksionaliteti i tyre
- Mungonin hapesirat e gjelberta dhe trotualet per kalimin e kembesoreve.
- Nuk kishte parking dhe as pika VGM.

Gjate matjeve ne terren u ve re se mungonte thuajse e gjithë infrastruktura e nevojshme. Nga ana jone është bere kërkesa per azhornime e te gjitha rrjeteve, te cilat do te merren parasysh gjate fazës se projektimit

FOTO TE GJENDJES EKZISTUESE

